



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 33/11

Prishtinë, më 01.11.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Jelena Bontic

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Aurora Ademi dhe Njomza Halilaj (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, datë 19.10.2011
3. Shqyrtimi i marrëveshjes për financimin për projektin për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për zhvillim
I ftuar : Bedri Hamza, Ministër i Financave;
4. Shqyrtimi i marrëveshjes për financimin shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për zhvillim
I ftuar Bedri hamza, Ministër i Financave
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/952/L-61 për shitjen e banesave për të cilat egziston e drejta banesore;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës

Rendi i ditës u miratuar pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, datë 19.10.2011

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i marrëveshjes për financimin për projektin për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim

Kryetarja, theksoi se kemi të bëjmë me një marrëveshje e nënshkruar në me Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, e cila përmban implikime buxhetore, dhe e njëjta duhet të kalojë duhet të aprovohet në Kuvend.

Bedri Hamza, theksoi se qëllimi i kësaj marrëveshje ka të bëjë me financimin e sektorit të bujqësisë. Kjo marrëveshje është diskutuar me përfaqësues të Bankës Botërore dhe përfaqësuesit nga ministria përfituese përkatësisht nga Ministria e Bujqësisë. Është një marrëveshje me kushte të volitshme ku ka një Greis periudhë prej 10 viteve. Kredia fillon kthehet në vitin 2021 dhe përfundon në vitin 2031. Sektori i bujqësisë është një prej sektorëve që ne e kemi identifikuar si sektor me prioritet dhe ka potencial për zhvillim. Ne sigurisht që synojmë që të kontribuohet në zhvillimin ekonomik fillimisht ne ngritjen e prodhimit në këtë sektor me qëllim të substitimit të produkteve të importuara me produkte vendore, por edhe mundësinë që në të ardhmen nëpërmjet përkrahjes direkte prej buxhetit por edhe përmes kredive të volitshme të përkrahet ky sektor. Vlëra e kësaj kredie është 12 milion e 800 mijë SDR që në kursin aktual është në vlerë prej 14 milion e 682 mijë €.

Hykmete Bajrami, theksoi marrëveshjet e tilla janë me kushte mjaftë të volitshme dhe janë të mirëseardhura sidomos për sektorin e bujqësisë. Meqenëse se marrëveshja ka të bëjë me për trajnime dhe forma të këshillëdhënieve për bujqit, theksoi se dëshirojë të di se a është bërë ndonjë studim i fizibilitetit për të parë se sa janë të nevojshme këto lloj trajnime dhe këshilla? Sepse duket si jo shumë konkrete që bujqve tanë të iu jepen këshilla kur ka shumë forma tjera më të mira për përkrahjen e sektorit të bujqësisë. Një shembull i mirë do të ishte që Qeveria të bënte një fond garantues për kredit në agrikulturë, ose edhe vetë zhvillimi i infrastrukturës në zona rurale, dhe besoj se këto forma do të ishin shumë më efektive se sa format e këshillëdhënies.

Bedri Hamza, vlerësoi se kemi nevojë që të ngritet vetëdija e gjithë atyre që merren me Bujqësi dhe gradualisht kalojmë nga bujqësia ekstensive në atë intensive. Normalisht ngritet kultura e bujqëve pastaj përgatitja e tyre në mënyrë që të kenë produktivitet më të madh në punën e tyre. Ne vlerësojmë që kushtet janë të volitshme dhe dëshirojmë të besojmë se ata që janë më përgjegjës në këtë e në këtë rast Ministria e Bujqësisë dhe Banka Botërore i kanë identifikuar prioritetet se ku është më me prioritet që të investohen këto para. Dhe meqenëse ata janë dakorduar në mes vete ne si Ministri e Financave e kemi proceduar projektin më tutje për aprovim.

Naser Osmani, theksoi se me buxhetin 2012, është ndarë 56 % më shumë buxhet për sektorin e Bujqësisë se sa vitet e kaluara dhe është renditur si prioritet i Qeverisë. Ajo çfarë mua më intereson është qëndrimi i juaj si Ministri e Financave për arsyeshmërin e kësaj kredie, kur dihet se po dedikohet për këshillëdhënie, pasi që ju e keni renditur këtë sektor si më me prioritet?

Bedri Hamza, sqaroi se është propozuar që për vitin 2012 të rritet buxheti i bujqësisë. Nëse e shikojmë përqindjen është përqindje mjaft e lart, por nëse e marrim bazën në të cilën është aplikuar kjo përqindje prapë sektori i bujqësisë mbetet tek rreth 21 milion € e që e konsiderojmë që është pak për këtë sektor. Ne mendojmë që jo vetëm kjo rritje dhe kjo kredi e dedikuar në sektorin e bujqësisë,

por edhe fondet tjera shtesë do të ishin të arsyeshme dhe të mirëseardhura për zhvillimin e këtij sektori.

Sali Asllanaj, theksoi se mbështetë qdo iniciativë që është në funksion të investimit në sektorin e bujqësisë, duke e konsideruar atë si një ndihmë për zgjidhjen e shumë problemeve sociale. Gjithashtu, mbështeti idenë që mbështetja e sektorit të bujqësisë të jetë në pjesën materiale dhe mos të kufizohet në pjesën operative.

Xhevdet Neziraj, theksoi që edhe viteve të kaluara u janë dhënë subvencione bujqëve, mirëpo një pjesë e tyre në një formë edhe janë keqpërdorur. Unë do të rekomandoja që të krijohet një mekanizëm për monitorimin e këtyre kredive dhe të shikohen se në çfarë mënyre ato mjete po shpenzohen, sepse edhe pse janë donacione të huaja, një pjesë të përgjegjësisë do ta ketë edhe buxheti i Kosovës. Prandaj, është mirë që brenda këtyre ministrive, përkatësisht në Ministrinë e Bujqësisë të krijohet një mekanizëm që ta përcillte rrjedhën e këtyre donacioneve.

Kryetarja, theksoi që investimet në sektorin e bujqësisë të çfarëdo natyre që të jenë do të ishin të mirëseardhura. Ministria ka konstatuar se sektori i bujqësisë është një sektor me prioritet dhe propozoi që ta miratojmë këtë marrëveshje dhe t’ia rekomandojmë Kuvendit për Miratim.

Pas diskutimeve, Komisioni nxorri këtë :

R E K O M A N D I M

I. I rekomandohet Kuvendit të ratifikohej Marrëveshjen për Financimin për Projektin për bujqësi dhe zhvillim rural në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për zhvillim.

4. Shqyrtimi i marrëveshjes për financimin shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për zhvillim

Kryetarja, theksoi se për marrëveshjen në fjalë kemi pasur një takim me përfaqësues të Bankës Botërore, disa nga anëtarët e Komisionit jemi të informuar, dhe ka të bëjë me mbështetjen e sektorit financiar, përkatësisht sigurimin e depozitave dhe sektorin kombëtar të pagesave, që udhëhiqet nga Banka Qendrore.

Bedri Hamza, sqaroi se kjo marrëveshje në vlerë prej 4.300 milion SDR që aktualisht me kursin valutor është 4.932 milion € ka të bëjë me përkrahjen e sektorit financiar. Gjithashtu ka Greis periudhë 10 vite, koha e fillimit të kthimit të kësaj kredie është 2021 dhe përfundon me datë 2031. Nga kjo pjesë 1.820 milion SDR e merr për obligim që ta kthej Banka Qendrore, ndërsa për Qeverinë e Kosovës mbetet 2.480 milion SDR. Kjo ka të bëjë me zhvillimin e sistemit kombëtar të pagesave, me sigurinë e këtij sistemi që në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore të ndërtohet edhe një qendër tjetër jashtë Prishtinës. Kontributin kryesor në këtë drejtim ka filluar ta jep Qeveria gjermane e cila është në vlerë prej 4.5 milion €, edhe Banka Botërore gjithashtu, kurse një pjesë tjetër do të jenë nga Qeveria e Kosovës derisa të arrihet kapitali fillestar në 15 milion €.

Naser Osmani, kërkoi sqarime më shumë rreth Ndërtimit të Qendrës së Sigurisë për ruajtjen e softuerëve dhe ruajtjen e informacioneve tjera që është vendosur të ndërtohet jashtë qytetit të Prishtinës, përkatësisht në Prizren. Sa është planifikuar me kujdes që ky ndërtim të bëhet në Prizren

pasi që nëse ndodh ndonjë fatkeqësi në vend ajo e përfshinë gjithë vendin, edhe pse në standard thuhet 40 km larg qendrës.

Bedri Hamza, sqaroi se për çështjen e Ndërtimit të Qendrës së Sigurisë është vlerësuar nga ekspertët konform standarteve më të avancuara të kësaj lëmie.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

REKOMANDIM

I. I rekomandohet Kuvendit të ratifikojë Marrëveshjen për Financim shtesë për fuqizimin e sektorit financiar dhe infrastrukturën e tregut në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/952/L-61 për shitjen e banesave për të cilat egziston e drejta banesore

Kryetarja, theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe duhet të kalojmë këtë projektligj që mos ta kalojmë afatin ligjor. Nëse komisionet tjera kompetente sjellin ndonjë amendament ne e shqyrtojmë prapë.

Xhevdet Neziraj, kërkoi që në atë takim që do të mbahet me ekspert të theksohet se ky ligj që katër vite nuk është miratuar. Edhe mandatin e kaluar ky ligj është shtyer pikërisht me kërkesë të përfaqësuesit special dhe disa ambasadave të huaja duke pritur ardhjen e ekspertëve nga Kroacia.

Kryetarja, theksoi se është mbajtur takimi me ekspertin dhe kryetarët e komisioneve funksionale dhe komisionit kryesorë dhe e kam pyetur ekspertin se a i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe ai është përgjigju se ky ligj nuk i cenon të drejtat dhe interesat e minoriteteve.

Komisioni njëzëri nxorri këtë vendim:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Të ndryshime

6.1. Kryetarja, njoftoi anëtarët se grupi punues për rregulloren e punës së Komisionit ka kryer punën dhe drafti iu është shpërndarë. Në këtë takim do të njoftoheni për këtë draft dhe në mbledhjen e radhës do të radhitet për shqyrtim dhe miratim në Komision, ku do të mund të bëhen edhe sugjerimet dhe rekomandimet për plotësimin dhe ndryshimin e saj.

Juergen Schatz, sqaroi rregullorja është mbështetur shumë në rregulloren e brendshme të Kuvendit të Kosovës, prandaj shumë pika që janë në këtë draft-rregullore janë të përmbledhura nga rregullorja e punës së Kuvendit. Dëshirojë të theksoi dy aspekte më të rëndësishme: Kjo draft-rregullore e përfshinë gjithë punën e Komisionit për Buxhet dhe Financa e cila do t'i rregulloj në mënyrë të detajuar të drejtat dhe përgjegjësit e Kryetarit të Komisioni, sekretariatit si dhe të dy zëvendësve të tij

apo saj, duke i përfshirë edhe çështjet teknike. Ajo çka është risi në këtë draft-rregullore është themelimi i Grupeve Punuese të përhershme, të cilat do të mbesin të tilla gjatë gjithë periudhës legislative dhe secili grup punues do të merret me një pjesë të buxhetit në mënyrë që të mbulohen të gjitha fushat. Një pikë tjetër e rëndësishme është se Rregullorja e Kuvendit të Kosovës e parasheh që për miratimin e një rregullore të re të punës nevojiten 2/3 e votave. Drafti parasheh që të votohet kjo draft-rregullore por ne nuk e kemi precizuar formën. Nëse mendoni që është e arsyeshme ne mund ti shtojmë disa fjali, mund ta bëjmë në mënyrë të thjesht informative.

Albana Fetoshi, propozoi që kjo draft- rregullore të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme meqenëse i ka disa vërejtje.

Kryetarja, sqaroi se sot nuk kemi bërë asnjë ndryshim dhe ishte vetëm një informacion sa i përket kësaj draft- rregullore. Gjithashtu, theksoi se përderisa nuk është miratuar ende rregullorja, të gjithë mund bëjnë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre deri në miratimin e saj.

6.2. Kryetarja, me qenë se projektligji për buxhetin ka ardhur në Kuvend, ne si komision duhet të angazhohemi për shqyrtimin e tij dhe kërkesave buxhetore. Përveç përkrahjes që do të kemi nga GIZ, propozoi që të angazhohen një apo dy ekspertë afatshkurtër që do të paguheshin nga buxheti i Komisionit në pajtim me udhëzimin përkatës. Propozoi që njëri prej ekspertëve të jetë Teki Shala, i cili tashmë ka përvojë në qeshjen e buxhetit dhe përgatitjes së amendamenteve. Ndërkaq nëse komisioni e vlerëson të nevojshme mund të angazhojmë edhe Safet Fazliu, cili vlerësohet se ka përvojë në çështjet teknike të buxhetit.

Latif Gashi, mbështeti propozimin e Kryetares, që komisioni ka nevojë të angazhojë dy ekspertë, të cilët janë do t'iu ndihmonin anëtarëve gjatë fazës së shqyrtimit të buxhetit. Safet Fazliu vlerësohet se ka përvojë në çështjen e buxhetit, por nuk do të thotë që patjetër të jetë ai, por megjithatë komisioni ka nevojë që të angazhojë dy ekspertë, kur dihet se edhe buxhetin e komisioni nuk e kemi shpenzuar.

Pas propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

- I. Miratohen propozimet për angazhimin e dy ekspertëve: Teki Shala dhe Safet Fazliu, në fazën e shqyrtimit të projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.
- II. Kushtet e punës dhe kompenzimit të tyre përcaktohen në pajtim me Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6.3. Kryetarja, njoftoi se nën organizimin e NDI, Kryetarja e Komisionit dhe Zëvendëskryetari i parë prej datës 2-4 nëntor do të marrin pjesë në një takim të organizuar në Sllovaki me Kuvendet e shteteve të rajonit, çështja është për financat dhe mbikëqyrjen e financave.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj